



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština – Assembly

HULUMTIM PARLAMENTAR

DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA

Shqip / Srpski

Përgatitur Për:

Komisionin Parlamentar për Arsim, Shkencë,
Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Nëntor 2015, Prishtinë

Ky hulumtim parlamentar është mundësuar me përkrahjen e USAID-së për projektin e zbatuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Ky projekt ka për qëllim të asistojë Drejtorinë për Hulumtime, Arkivë dhe Bibliotekë me hulumtime nga institutet hulumtuese jashtë Kuvendit në fusha të caktuara dhe specifike.

Hulumtimi është bërë me kërkesë të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport dhe është ekskluzivisht për Kuvendin e Kosovës dhe Komisionin që e ka kërkuar. Po ashtu, këto hulumtime i përmbahen kriterëve të objektivitetit, paanshmërisë dhe nuk synojnë të japin rekomandime por vetëm të dhëna faktike dhe praktika ndërkombëtare.

Ky hulumtim u përgatit nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Përmbajtja e këtij hulumtimi nuk paraqet pikëpamjet apo qëndrimet e USAID-it apo KDI-së.

Përmbledhja

I. PARATHËNIE	4
II. BAZA LIGJORE.....	4
Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta	4
Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit.....	5
Rregullorja për Ndërmjetësim të Kontesteve për të Drejtës së Autorit.....	5
Rregullorja për procedurat e dhënies, shoqatave për administrim kolektiv të të Drejtave	5
III. SFIDAT NË TË DREJTAT E AUTORIT	6
Baza Ligjore.....	6
Mbikëqyrja e tregut	6
Zbrazëtira Ligjore	7
Administrimi kolektiv i të drejtave	7
Fusha e Medieve dhe Gazetaria	7
Veprat kinematografike dhe arkitektonike.....	8
IV. ÇËSHTJET KYÇE NË LIGJ DHE ALTERNATIVAT	8
1. Veprat jetime	9
2. Riprodhimi dhe rishitja	9
3. Kohëzgjatja e të drejtave dhe e mbrojtjes	10
4. Provat dhe sigurimi i tyre	11
5. Masat e përkohshme	11
6. Shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave.....	12
7. Çështje të tjera	12
– Gabimet Drejtshkrimore/Teknike	12
V. PRAKTIKAT NDËRKOMBËTARE	14
VI. REFERENCAT.....	18
VII. SHTOJCA I	19
Direktivat Evropiane.....	19

I. PARATHËNIE

Mbrojtja e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përfaqëta paraqet një fushë mjaft komplekse në lëmin e pronësisë intelektuale. Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim, Kosova ka marrë përsipër angazhime shtesë sa i përket përafrimit të legjislacionit dhe marrjes së hapave konkretë për të adresuar problemet e ballafaquara deri tani në këtë fushë. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian shkurtimisht prek fushën e të Drejtave të Autorit, duke theksuar se Task Forca kundër Piraterisë ka vazhduar me kampanja vetëdijësuese, dhe duke potencuar se ende nuk ka marrëveshje mes shoqatave kolektive dhe medieve elektronike.

Përkundër këtij vlerësimi shumë të shkurtër, duhet të theksohet se kjo temë është shumë më komplekse dhe është e pamundur të mbulohet me një paragraf të vetëm. Pjesët në vijim të këtij dokumenti bëjnë një përmbledhje të kornizës së tanishme ligjore në këtë fushë, paraqesin sfidat kryesore të identifikuara në zbatim të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përfaqëta, si dhe krahasojnë dispozitat e parapara në projektligjin të cilin komisioni parlamentar e ka në shqyrtim, me dispozitat përkatëse të disa vendeve të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, bazuar në sfidat e paraqitura, dokumenti përmban një krahasim me mënyrën se si një çështje e caktuar është rregulluar në vendet e zgjedhura.

II. BAZA LIGJORE

Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përfaqëta

I publikuar në gazetën zyrtare më 21 Tetor 2011, Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përfaqëta rregullon të drejtat e autorit që u takojnë autorëve përkitazi me veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit, si dhe të drejtat e përfaqëta të interpretuesve, prodhuesve të fonogrameve dhe videogrameve, shërbyesve medial, prodhuesve të bazave të të dhënave, dhe botuesve. Sipas këtij ligji, masat administrative, inspektimi, mbrojtja juridiko-civile dhe penale zbatohen në përputhje me rregullat e përgjithshme të procedurës administrative dhe gjyqësore.

Ligji në tërësi përcakton të veprat e mbrojtura si dhe krijimet të cilat janë pa mbrojtje. Gjithashtu, theksohen edhe të drejtat e kufizimet në riprodhim dhe shpërndarje të veprave të mbrojtura. Ndër të tjera, përcaktohen edhe kompensimet e parapara për shfrytëzim të veprave, si dhe huazimi publik. Pas afateve që përcaktohen me ligj, veprat e mbrojtura kalojnë në përdorim publik.

Ky ligj trajton edhe administrimin individual dhe kolektiv të të drejtave të autorit. Ndërsa sa i përket masave për zbatimin e mbrojtjes, në ligj përcaktohen edhe dispozitat ndëshkuese që duhet të aplikohen në rast të shkeljeve.

Ndryshimi dhe Plotësimi i Ligjit

Në përgjithësi, ligji bazik ka paraqitur një bazë mjaft të mirë për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në Kosovë. Mirëpo, duke marrë parasysh se prej vitit 2011 ka pasur shumë ndryshime në këtë fushë edhe në komunitetin Evropian, është vendosur që i njëjti të amandamentohet dhe të harmonizohet me direktivat më të reja të Bashkimit Evropian në këtë fushë, sipas shtojcës I të këtij dokumenti.

Rregullorja për Ndërmjetësim të Kontesteve për të Drejtës së Autorit

Me qëllim që të rregullohet procedurat për ndërmjetësim të kontesteve në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë këtë rregullore me qëllim që e njëjta të shërbejë si udhërrëfyes mbi nivelin, llojin e edukimit, dhe kushtet tjera që një ndërmjetësues duhet t'i plotësojë për ndërmjetësim në raste të këtij lloji. Tabela e paraqitur nën pjesën III të këtij dokumenti përmbledh ndryshimet kryesore që i bëhen ligjit bazik me projektligjin e ri, dhe i krahason ato me praktikën e Bashkimit Evropian dhe shteteve të tjera më të përafërta me Kosovën.

Rregullorja për procedurat e dhënies, shoqatave për administrim kolektiv të të Drejtave

Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sportit ka nxjerrë Rregulloren Nr. 05/2013 për Ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në muajin korrik 2012. Kjo rregullore përcakton procedurat për dhënien dhe marrjen e lejes së shoqatave të administrimit kolektiv të të drejtave, më saktësisht procedurat e aplikimit, kushtet që duhen plotësuar nga këto shoqata, si dhe afatet kohore të nevojshme në proceset administrative të verifikimit të dokumenteve dhe marrjes së vendimit.

III. SFIDAT NË TË DREJTAT E AUTORIT

Në mënyrë që të identifikohen çështjet dhe problemet më të shpeshta në fushën e të drejtave të autorit e që lidhen me ligjin që rregullon këtë fushë, janë zhvilluar intervista me persona në pozita të ndryshme udhëheqëse në këtë fushë. Për qëllim të këtij hulumtimi janë intervistuar: Valon Kashtanjeva, drejtor i Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta; Lulzim Sylja, Kryeinspektor i Inspektoratit të Tregut; Kujtesa Nezaj, juriste dhe eksperte në fushën e pronësisë intelektuale; Ardita Zejnullahu, drejtoreshë ekzekutive e Asociacionit të Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës; Arben Zharku, drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës; Eljesi Surdulli, drejtor i Shoqatës së Arkitektëve.

Baza Ligjore

Ngjashëm si me shumicën e ligjeve në Kosovë, të intervistuarit shprehen se në përgjithësi Ligji për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (Ligji DADP) është i mirë dhe i avancuar, mirëpo problemet më të mëdha janë hasur në zbatim të ligjit nga institucionet përgjegjëse. Kujtesa Nezaj, eksperte ligjore në fushën e pronësisë intelektuale sqaron se në masë të madhe ligji është në harmoni me dispozitat përkatëse të Bashkimit Evropian, dhe se ndryshimet e parapara në projektligj pritet të adresojnë nevojën për adoptimin e disa direktivave të reja. Sipas Nezaj, me përjashtim të disa rasteve specifike (shumë nga të cilat sqarohen më poshtë), ligji është shumë i qartë, por nevojitet një vullnet më i madh dhe kapacitete më të mëdha të institucioneve përgjegjëse për mbikqyrje të respektimit të tij.

Mbikëqyrja e tregut

Kryeinspektori i tregut, Lulzim Sylja, njofton se gjatë shtatë-mujorit të parë të këtij viti janë sekuestruar rreth 600 DVD, 300 CD, dhe rreth 700 libra për shkelje të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta. Si rezultat i punës që është bërë në këtë drejtim, Sylja ka vlerësuar se në tregun e Kosovës ka pasur rënie të dukshme të piraterisë. Megjithatë, sipas Sylës, edhe pse fusha e të drejtave të autorit parashihet të jetë në kompetencë të inspektoratit të tregut bazuar në Ligjin mbi Inspektoratin, nevojitet që kompetencat e këtij inspektorati dhe procedurat e aplikueshme të parashihen dhe sqarohen në Ligjin DADP. Gjithashtu, Valon Kashtanjeva, drejtor i Zyrës për të drejtat e Autorit në Ministri të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, tha se nuk ka kapacitete të mjaftueshme në kuadër të Inspektoratit të Tregut për të bërë inspektimin dhe sekuestrimin e nevojshëm të produkteve të cilat kanë shkelur të drejtat. Në këtë drejtim, themelimi i Task Forcës kundër piraterisë, ka avancuar bashkëpunimin dhe koordinimin ndër institucional për marrjen e hapave konkrete për të adresuar disa probleme apo shkelje të rënda në fushën e të drejtave të autorit.

Shqetësues mbetet fakti se autorët janë të dekurajuar për të kërkuar zbatimin e drejtë të marrëveshjeve me shtëpitë botuese kur këto të fundit bëjnë tejkallim të autorizimeve, duke parë procedurat gjyqësore si burokratike dhe jo-eficiente, edhe pse ligji në fuqi parasheh që kontestet në fushën e të drejtave të autorit seancat gjyqësore të fillojnë jo më larg se 3 muaj nga dorëzimi i padisë. Gjithashtu, ekzistojnë dispozita për marrjen e masave të përkohshme në periudhë 7 ditore. Kjo tregon një besim tejet të ulët në sistemin gjyqësor në vend.

Zbrazëtira Ligjore

Një çështje problematike që është ngritur në intervista është edhe një zbrazëtira ligjore në dispozitat që parashohin ndëshkimet e aplikueshme. Nenet 190-192 parashohin ndëshkime të ndryshme për persona juridik. Megjithatë, Ligji për Shoqëri Tregtare, neni 48, paragrafi 5, thotë si në vijim: “Ndërmarrja individuale nuk është person juridik. Pavarësisht nga kjo, ajo mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë e paditur, në emrin e saj apo të pronarit.” Duke pasur parasysh se rreth 90% e ndërmarrjeve në Kosovë janë biznese individuale, sipas ligjit DADP, këto biznese nuk janë subjekt i dispozitave ndëshkuese. Inspektorati i tregut njofton se ka raste kur gjykata ka kthyer mbrapsht vendimet e inspektoratit mbi biznese individuale duke potencuar mungesën e bazës ligjore për të ndëshkuar ata.

Administrimi kolektiv i të drejtave

Një pikë tjetër shqetësuese është edhe mungesa e marrëveshjes mes shoqatave për administrim kolektiv dhe medieve për tarifën mbi shfrytëzimin e të drejtave të autorit. Ardita Zejnullahu, drejtoreshë ekzekutive në Asociacionin e Medieve të Pavarura Elektronike të Kosovës, thekson se kërkesat dhe propozimet e dy shoqatave ekzistuese deri tani kanë qenë të tepruara dhe jo në përputhje me situatën në Kosovë. Zejnullahu thekson se qëndrimi i AMPEK është që të ngarkohen mediat bazuar në sa herë një vepër e caktuar shfrytëzohet (emetohet), dhe jo bazuar në qarkullimin e përgjithshëm, siç ka qenë fillimisht propozimi i shoqatave. Si rezultat i mungesës së një marrëveshjeje, tani dy shoqatat ekzistuese, Shoqata e Autorëve, Prodhuesve dhe Interpretëve të Kosovës (APIK), si dhe Artistët vizuel, producentët dhe interpretuesit e Kosovës (VAPIK), tani ballafaqohen me probleme të mëdha financiare.

Fusha e Medieve dhe Gazetaria

Në fushën e medieve dhe gazetarisë, një problem tjetër i paraqitur është edhe mungesa e definimit të lajmit të ditës në Ligjin për të Drejtat e Autorit, që po mundëson kopjimin e lajmeve nga njëri medium në tjetrin, gjë që është një dekurajim

i madh për gazetari hulumtuese. Definimi i lajmit të ditës do të mundësonte një respektim më të madh në fushën e të drejtave të autorit në industrinë e medieeve, duke vënë kërkesa për citim të duhur të burimit, apo mundësi të shfrytëzimit të burimit pas një periudhe të caktuar kohore kur mund të konsiderohet një lajm si ekskluziv.

Veprat kinematografike dhe arkitektonike

Sa i përket produksioneve filmike, Arben Zharku, drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës sqaron se kur produksionet nuk kanë qëllim komercial, në përgjithësi ka një kulturë të mirë të respektimit të së drejtës së autorit dhe të marrëveshjeve të lidhura, qoftë nga televizionet apo edhe nga kinematë. Zharku sqaron sfidat mbi piraterinë dhe tejkalimin e autorizimeve në industrinë komerciale të produksioneve filmike. Sa i përket piraterisë, sqaron se situata është përmirësuar dukshëm, mirëpo se ka ende hapësirë për përmirësime për piraterinë elektronike.

Në fushën e veprave arkitektonike, Eljasi Surdulli, kryetar i Shoqatës së Arkitektëve sqaron se ka raste kur vetë organet publike dekurajojnë autorët e veprave duke shpallur tenderë për projektim të ndonjë objekti të caktuar, i cili pastaj riprodhohet shumë herë në komuna apo vende tjera (shembull shkolla). Kjo shoqatë e sheh një gjë të tillë si zhvlerësim të punës dhe minimizim të të drejtave të autorit në industrinë e tyre.

IV. ÇËSHTJET KYÇE NË LIGJ DHE ALTERNATIVAT

Projektligji i propozuar për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta parasheh një numër të amandamentimeve të cilat i bëhen ligjit bazik me qëllim që ky i fundit të harmonizohet në tërësi me direktivat e Bashkimit Evropian. Megjithatë, nga diskutimet me akterët kyç të kësaj fushe, mund të kuptohet se në secilën fushë që projektligji e ka prekur, ka sfida të ndryshme dhe aspekte që kërkojnë vëmendje. Pjesët vijuese të kësaj pjese të dokumentit trajtojnë (i) Veprat jetime, (ii) Riprodhimin dhe rishitjen, (iii) Kohëzgjatjen e të drejtave, (iv) kohëzgjatjen e mbrojtjes, (v) Provat dhe sigurimi i tyre, (vi) Masat e përkohshme, (vii) Shoqatat për Administrim Kolektiv të të drejtave, si dhe (viii) Çështje të tjera me qëllim që të analizohet nëse të njëjtat janë rregulluar në mënyrë të duhur për gjendjen aktuale në Kosovë dhe nëse janë në harmoni me praktikat ndërkombëtare.

1. Veprat jetime

Në vitin 2012 fusha e veprave jetime në Bashkimin Evropian është rregulluar me anë të Direktivës 2012/28/EU, e cila është përdorur si shembull edhe në nenet e reja 12A-12D mbi veprat jetime, kërkimin e plotë të autorëve dhe burimet për këtë kërkim, si dhe dispozitat mbi përfundimin e këtij statusi. Në këtë aspekt, sipas Projektligjit të ri, veprat jetime janë ato vepra autori i së cilave nuk është identifikuar apo është identifikuar por i njëjti nuk është gjetur. Në përputhje me atë që thuhet në direktivë, edhe me projektligjin e ri kërkohet që një kërkim i detajizuar të bëhet para se të vihet në konkluzionin që një vepër mund të quhet jetime. Është e rëndësishme të ceket se institucionet të cilave u lejohet t'i përdorin veprat jetime janë: bibliotekat, institucionet arsimore dhe muzetë që ofrojnë qasje publike, si dhe nga arkivat, institucionet e trashëgimisë audio apo të filmit dhe organizatat publike transmetuese, të themeluara në Republikën e Kosovës, në mënyrë që të përmbushin qëllimet e tyre lidhur me misionin e interesit publik.

Rëndësia e definimit të qartë të statusit ligjor dhe mbrojtjes së këtyre veprave intensifikohet duke marrë parasysh se me digjitalizimin e shërbimeve të ofruara nga institucionet e cekura më lartë (bibliotekat, arkivat, etj.) do të shtohet nevoja për transformim të veprave nga kopje fizike në formë elektronike. Gjithashtu, sipas një raporti të Departamentit të Shtetit të ShBA-së, mungesa e legjislacionit që specifikon trajtimin që u duhet bërë veprave të tilla mund të shtyjë përdoruesit e tyre (bibliotekat, arkivat, muzetë) të mos i përdorin fare ato për shkak të shkeljeve të mundshme që mund të bëhen. (United States Copyright Office, 2015).

Në përgjithësi, në vendet e rajonit, përfshirë këtu edhe Kroacinë e Slloveninë, kjo çështje është rregulluar në mënyrë të ngjashme, gjithmonë duke u bazuar në Direktivat e Bashkimit Evropian.

2. Riprodhimi dhe rishitja

Me Nenin 5 të Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, parashihet që ligjit bazik t'i shtohet definicioni i fjalës riprodhim që përkufizohet si “*bërja e një ose më shumë kopjeve të një vepre apo objekti të të drejtave të përafërta, qoftë drejtpërdrejtë apo tërthorazi, dhe në mënyrë të përkohshme apo të përhershme, në çfarëdo lloj forme, në formë të plotë apo të pjesshëm, përfshirë çdo regjistrim audio ose video, dhe ruajtje të përkohshme apo të përhershme të veprës apo objektit të të drejtave të përafërta në një medium elektronik.*” Sipas Direktivës 2001/29/EC, është e rëndësishme që në çdo shtet të lejohet riprodhimi i veprës deri në një masë dhe vetëm për qëllime të duhura, pasi që shpeshherë disa vepra mund të jenë pjesë integrale të proceseve të tjera. Gjithsesi, se ekzemplarët e riprodhuar nuk duhet të bartin vlerë të ndarë ekonomike. Prandaj, kufizime të llojit që është bërë me paragrafin 1 të Nenit 5 të Projektligjit ku autori e

mban të drejtën ekskluzive që të lejojë apo jo riprodhimin e një vepre, mund të paraqesë sfidë për autorë të tjerë.

Ligji bazik gjithashtu parasheh se në rast të rishitjes së origjinalit të veprës artistike pas tjetërsimit të parë të saj nga ana e autorit, autori ka të drejtë të jetë i njoftuar për rishitje, si dhe të drejtë në kompensim në shumën e përcaktuar me ligj. Kjo dispozitë është plotësuar nga Neni 7 i Projektligjit, ku thuhet se autori ka të drejtë që deri në 3 vite pasi të ketë ndodhur rishitja të kërkojë informacione për të pranuar pjesën e tij të kompensimit.

3. Kohëzgjatja e të drejtave dhe e mbrojtjes

Në mënyrë që të mundësohet njohja shoqërore e kontributeve artistike dhe kreative nga shoqëria, kohëzgjatja e të drejtave në parim zgjat për aq sa është gjallë autorit dhe 70 vjet pas vdekjes së tij. Mirëpo, varësisht prej specifikave të veprave, mënyrës se si ato janë bërë publike, si dhe llojin e të drejtës, afatet ndryshojnë. Me projektligjin e ri parashihet që afati i mbrojtjes së veprave muzikore të përfundojë 70 vjet pas vdekjes së personit të fundit të involvuar në prodhimin e asaj vepre, edhe nëse të njëjtit nuk janë autorë apo bashkautorë.

Një dispozitë e tillë ka rrjedhur nga Direktiva 2011/77/EU, në paradhënien e së cilës thuhet se si rezultat që mbrojtja e veprave muzikore me tekst rregullohet ndryshe nga shteti në shtet dhe se kjo mund të rezultojë në pengesë të lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve, është vendosur që mbrojtja të mos lihet në diskrecionin e anëtarëve, mirëpo e njëjta të qartësohet me këtë direktivë. Kosova ka bazuar këtë dispozitë të ligjit tërësisht në direktivën e BE-së.

Për sa i përket kohëzgjatjes së mbrojtjes së të drejtave për interpretuesit, me nenin 17 të Projektligjit, parashihet që Neni 137 i Ligjit Bazik të ndryshohet, për të ofruar mbrojtje më të gjatë të të drejtave. Përderisa në Ligjin Bazik thuhet se pa marrë parasysh rrethanat në të cilat një vepër bëhet publike, të drejtat pasurore të interpretuesit zgjasin për 50 vjet nga publikimi apo komunikimi në publik. Me projektligjin e ri, përkitazi me Direktivën 2011/77/EU parashihet që: (1) nëse vepra nuk është fiksuar në fonogram, e njëjta të mbrohet për 50 vjet pas publikimit të saj të ligjshëm; dhe (2) nëse vepra është fiksuar në fonogram, të mbrohet për 70 vjet nga data e publikimit të parë.

Me Nenin 141 të Ligjit bazik parashihet që të rregullohen të drejtat e prodhuesit të fonogramit, ku kohëzgjatja e tyre është 50 vjet nga koha e fiksimit të fonogramit. Ngjashëm si me rastet tjera, nëse brenda kësaj periudhe fonogrami publikohet apo i komunikohet publikut (në mënyrë të ligjshme apo jo) atëherë kohëzgjatja e të drejtave është 70 vite nga ajo datë.

4. Provat dhe sigurimi i tyre

Direktiva e Bashkimit Evropian 2004/48/EC e datës 29 Prill 2004, mbi zbatimin e të drejtave pronësore intelektuale, përcakton procedurat që duhet ndjekur për iniciimin dhe mbledhjen e provave për pretendimet e ndryshme për shkelje. Më saktësisht, Neni 6 i kësaj direktive që thotë se nëse njëra nga palët ka bazë të mjaftueshme për të besuar se provat mbi një rast të ngritur i mban pala tjetër, trupat gjyqësore kanë të drejtë që të kërkojnë mbledhjen e provave. E njëjta dispozitë është transpozuar në Nenin 27 të Projektligjit (që do të jetë i aplikueshëm për Nenin 184 të ligjit bazik). Në këtë aspekt, me Direktivën 2004/84/EC diskrecioni për të vendosur mbi numrin e mostrave të një veprë të cilës i janë shkelur të drejtat, e cila do të paraqitet si provë, i është lënë shteteve anëtare. Përderisa, në Kosovë, një kompetencë e tillë i është transferuar gjykatës, dhe e njëjta nuk rregullohet me ligj.

Sa i përket sigurimit të provave, Neni 27 i Projektligjit (që do të jetë i aplikueshëm për Nenin 185 të ligjit bazik) është në harmoni thuajse të plotë me Direktivën 2004/48/EC, në aspekt të procedurave që duhet ndjekur. Disa nga ndryshimet që mund të hasen, janë tek procedura që duhet ndjekur për të sigurimin e provave, ku në Projektligj thuhet se një gjë e tillë duhet të bëhet përkitazi me Procedurën Civile. Përderisa Kosova nuk ka Kod Civil, duhet që me këtë projektligj t'i referohemi dispozitave përkatëse të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Gjithashtu, përderisa në Direktivën e BE-së thuhet se afati për iniciim të procedurës gjyqësore nga pala propozuese pas sekuestrimit të malli është 20 ditë punë apo 31 ditë kalendarike, me projektligj thuhet se kjo bëhet brenda 15 ditësh.

5. Masat e përkohshme

Ligjit bazik për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta i shtohet Neni i ri 186 i cili rregullon masat e përkohshme që Gjykata mund t'i marrë në rast se ka dyshime për shkelje dhe nëse pala propozuese ka prova të mjaftueshme për të sugjeruar diçka të tillë. Në këtë aspekt, gjykata mund të lëshojë urdhër të përkohshëm, të ndalojë përkohësisht, kërkojë garanci financiare nga shkelësi për dëmet eventuale që mund t'i shkaktohen palës propozuese. Gjithashtu, gjykata ka të drejtë që të sekuestrojë mallin apo të vendosë gjobë kundër palës e cila bën shkeljen. Në rast se shkelja bëhet në përmasa komerciale, ky projektligj parasheh që gjykata ka të drejtë të bëjë bllokimin e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme të shkelësit.

Dispozitat vazhduese të këtij neni parashohin edhe që masat e përkohshme mund të merren pa dëgjuar palën e akuzuar, se gjykata mund të kërkojë dëmshpërblim nëse pala e akuzuar nuk ka bërë shkelje në të vërtetë, si dhe afatet brenda të cilave duhet të iniciohet procedura gjyqësore. Kjo e fundit është pika e vetme ku opsioni i propozuar ndryshon me Nenin 9 të Direktivës 2004/48/EC, pasi që të gjitha dispozitat tjera janë transpozuar në mënyrë të plotë në projektligj.

6. Shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave

Duke pasur parasysh sfidat e lartpërmendura të Shoqatave për Administrim Kolektiv të të Drejtave, dhe duke konsideruar sfidat e hasura që të arrihet një kompromis mes këtyre shoqatave dhe shfrytëzuesve të të drejtave, propozimet e dhënë në projektligjin aktual janë analizuar karshi praktikave të Kroacisë dhe Direktivës 2014/26/EU e cila është më e fundit e Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Përderisa me Nenin 20 të Projektligjit të propozuar në Kosovë, janë cekur 7 domene të gjera të të drejtave që mbrohen ekskluzivisht nëpërmes shoqatave kolektive, me Ligjin e të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përafërta të Kroacisë, lejohet mundësia që çdo e drejtë të menaxhohet në mënyrë individuale apo kolektive.

Gjithashtu, Neni 156 i Ligjit të Kroacisë ofron një shpjegim më të lehtë për lexuesin sa i përket të drejtave që mund të administrohen në formë kolektive, duke i grupuar ato sipas mbajtësve të të drejtave.

7. Çështje të tjera

Ashtu si është elaboruar në pjesën paraprake të këtij dokumenti, Nenet 190-192 të Ligjit bazik parashohin ndëshkime të ndryshme vetëm për persona juridik, ndërsa e njëjta nuk gjen zbatim tek personat fizik. Në këtë drejtim, Ligji për Shoqëri Tregtare, neni 48, paragrafi 5, thotë se: “Ndërmarrja individuale nuk është person juridik...” Duke pasur parasysh se rreth 90% e ndërmarrjeve në Kosovë janë biznese individuale, ligji i tanishëm nuk parasheh ndëshkim nëse këto subjekte shkelen të drejtat e autorit apo të drejtat e përafërta. Tabela më poshtë jep një krahasim mes mënyrës se si Shqipëria, Danimarka, dhe Sllovenia e rregullojnë këtë çështje.

Gabimet Drejtshkrimore/Teknike

Në projektligjin e propozuar, janë hasur edhe disa gabime drejtshkrimore, teknike, si dhe gabime në përkthim, të cilat janë cekur në tabelën vijuese:

Nr.	Neni	Si është e rregulluar	Propozimi
1.	Neni 1	Ky Ligj është në përputhshmëri të plotë me këto direktiva të Bashkimit Evropian: Direktivën 98/83/EEC e datës 27 Shtator 1993	Ky Ligj është në përputhshmëri të plotë me këto direktiva të Bashkimit Evropian: Direktivën 93/83/EEC e datës 27 Shtator 1993
2.	Neni 4	Ligjit bazik i shtohen katër nene të reja, neni 12A, neni 12B, neni 12C dhe neni 12D	Pas Nenit 12 të ligjit bazik, shtohen katër nene të reja, neni 12A, neni 12B, neni 12C dhe neni 12D
	Neni 10	1. ... duke rënë dakord që këto regjistrime të fshihen ose të shkatërrohen jo më vonë se brenda dymbëdhjetë muajsh pas transmetimit.	Neni 10 në gjuhën angleze thotë: <i>‘On the understanding that such recordings shall be erased or destroyed after six months.’</i>

			Duhet të qartësohet se a bëhet fjalë për 12 apo 6 muaj.
3.	Neni 20	E drejta për të mbledhur një shpërblim...	Të drejtën për të mbledhur një shpërblim...
4.	Neni 21	Paragrafi 3 i Nenit 161 të Ligjit bazik fshihet në tërësi, këtij neni i shtohen paragrafët 2 dhe 6, me tekstin si në vijim	Paragrafi 2 i Nenit 161 të Ligjit bazik fshihet në tërësi, këtij neni i shtohen paragrafët 2 dhe 6, me tekstin si në vijim
5.	Neni 23	2.3 Kapacitetin i vendit ku përdoren veprat...	2.3 Kapacitetin e vendit ku përdoren veprat...

V. PRAKTIKAT NDËRKOMBËTARE

	Shqipëri	Kroaci	Slloveni	Tjetër
Veprat Jetime	Nuk mbulohet kjo fushë- nuk është harmonizuar	Identik si versioni i propozuar për Kosovë	Nuk mbulohet kjo fushë- nuk është harmonizuar	<p>Danimarka:</p> <p>Në përgjithësi direktiva e njëjtë është transpozuar me përjashtim të disa ndryshimeve:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Burimet e kërkimit të plotë nuk rregullohen me ligjin bazik për të Drejtat e Autorit. Ligji parasheh që Ministria e Kulturës në Danimarkë të nxjerrë rregullore për procedurat që duhet ndjekur dhe burimet që duhet shterur që të konkludohet se institucionet kanë kryer një hulumtim gjithëpërfshirës para se të shfrytëzojnë një vepër si vepër jetime. 2. Dispozita për kompensimin e autorëve pasi ata bëhen të njohur është e vendosur në Nenin ku flitet për përfundimin e statusit të veprës jetime, dhe jo tek dispozitat që rregullojnë përdorimin i lejuar
Riprodhimi dhe Rishitja	Nuk parashihen kufizime të tilla në legjislacionin e tanishëm	Kufizimi i tanishëm sa i përket incizimeve kalimtare është 1 muaj nga transmetimi fillestar	<p>Sa i përket riprodhimit, ai mund të bëhet pa të drejtën e autorit vetëm kur është në benefit të personave me nevoja të veçanta.</p> <p>Në aspekt të rishitjes, ashtu si në Projektligjin e propozuar në</p>	<p>Serbi:</p> <p>Kufizimi i tanishëm sa i përket incizimeve kalimtare është 3 muaj nga transmetimi fillestar</p> <p>SHBA:</p> <p>Kufizimi është 6 muaj</p>

	Shqipëri	Kroaci	Slloveni	Tjetër
Kohëzgjatja e të drejtave dhe mbrojtjes	Kohëzgjatja e të drejtave dhe mbrojtjes së tyre është rregulluar në mënyrë të njejtë në të gjitha vendet e rajonit përfshirë në Shqipëri, Mal të Zi, Serbi, Kroaci, e Slloveni. Edhe Zvicra dhe Danimarka kanë aprovuar politika të ngjashme, të cilat në të gjitha rastet, rrjedhin nga Direktiva 2011/77/EU.			
Provat dhe sigurimi i tyre	Ligji aktual në Shqipëri nuk përmban dispozita që e rregullojnë barrën e provës dhe nuk ka dispozita që detyrojnë shpalosjen e provave për shkelësin e pretenduar.	Kroacia fillimisht në ligj ka paraparë vetëm detyrim për palët afariste për të shpalosur informata mbi furnitorët e tyre në rastin kur ka pretendim se një produkt që tregtohet është duke shkelur të drejta të autorit. Kroacia më pastaj ka amendamentuar ligjin duke përfshirë direktivat e reja të Bashkimit Evropian. Dispozitat e përfshira në ligjin e ri janë tërësisht të njëjta me propozimin e përfshirë në projektligjin e Kosovës, duke përfshirë sigurimin e provave dhe detyrimin ligjor për të shpalosur provat që pretendohen nga pala kundërshtare.	Ligji Slloven përmban dispozita specifike për procedurat mbi ruajtjen e provave, si dhe mbi shpalosjen dhe prezantimin e provave nga pala kundërshtare. Gjithashtu, ligji parasheh se në rast se vërtetohet se nuk ka pasur shkelje nga pala ndaj të cilës është paraqitur ankesa, kjo palë ka të drejtën që të kërkojë dëmshpërblim financiar, si dhe të kërkojë garanci se informatat e shpalosura gjatë procedurave nuk do t'i jepen publikut. Ngjashëm parashihet edhe në projektligjin e Kosovës.	Serbi: Sipas Ligjit në Serbi, pala ka të drejtë që të kërkojë sigurimin e provave edhe pa parashtruar lëndë në gjykatë, vetëm nëse rasti paraqitet në gjykatë deri në 30 ditë pas marrjes së provës.
Masat e përkohshme	Sipas ligjit në Shqipëri, sa i përket procedurave që duhet ndjekur në rast të shkeljeve apo dyshimeve për shkelje, ato duhet të realizohen përkritazi me Kodin	Sipas legjislationit kroat, marrja e masave të përkohshme iniciohet nga një person i autorizuar, i cili për një arsye apo tjetër ka njohuri apo dyshime që një shkelje ka ndodhur.	Nuk kërkohet që të dorëzohet garanci financiare për sigurimin e dëmit potencial që mund t'i bëhet palës së kundërt.	Mali i Zi Në përgjithësi, ligji i Malit të Zi parasheh masa të parakohshme që janë deri diku të ngjashme me ato të Kosovës, përfshirë sekuestrimin e mallit, ndalimin e aktivitetit, etj.

	Shqipëri	Kroaci	Slloveni	Tjetër
	Civil.	Gjithashtu, gjykata nuk e ka të paraparë me ligj që të kërkojë garanci financiare nga njëra apo tjetra palë, për të mbuluar detyrimet e mundshme që mund të dalin.		Ligji në Mal të Zi parasheh edhe që shkelësi i të drejtave të paguajë mbajtësin e tyre për çdo shkelje që bën sipas rregullave të përgjithshme të kompensimit të dëmeve material, ose në shumën për të cilën palët bien dakord.
Shoqatat për administrim kolektiv të drejtave	Sipas ligjit në Shqipëri, agjencitë për administrim kolektiv të të drejtave krijohen sipas fushave të artit, por jo më shumë se nga një agjenci për fushë. Ligji nuk parasheh procedura të negocimit të tarifave me shfrytëzues të të drejtave.	Kroacia ka një shpjegim të detajuar se cilat të drejta mund të administrohen nga shoqatat kolektive. Ligji parasheh që shoqatat për administrim kolektiv të negociojnë me shfrytëzues. Në rast se nuk ka dakordim, atëherë kjo shoqatë duhet t'i dërgojë një propozim me shkrim për tarifa Odës Ekonomike Kroate, Odës Tregtare dhe të Artizanateve, dhe Shoqatës së Transmetuesve.	Procedurat për negociim të tarifave për shfrytëzim të veprave të autorit mes Shoqatave Kolektive dhe asociacionit të shfrytëzuesve janë të ngjashme si në Kosovë. Megjithatë, në rast të pamundësisë së arritjes të marrëveshjes, tarifën e cakton Bordi i të Drejtave të Autorit, i cili përbëhet nga një gjyqtarë dhe nga dy përfaqësues të deleguar nga shoqatat respektive.	Serbi: Momentalisht menaxhimi kolektiv i të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta është shtyer deri në momentin që themelohen organizata funksionale për menaxhimin kolektiv të të drejtave dhe deri në harmonizimin e plotë të legjislacionit të Serbisë me atë të Bashkimit Evropian.
Ndëshkimet për personat juridik/fizik	Legjislacioni i Shqipërisë nuk bën dallim mes personit juridik dhe fizik, por vetëm ceket se “..veprimtaria e çdo personi, i cili nuk ka regjistruar dhe certifikuar paraprakisht objektin e veprimtarisë së vet në Zyrën Shqiptare për të Drejtat	Kur i referohet shkeljeve, ligji kroat gjithmonë i bën ato me referencë për një person fizik apo juridik. P.sh. Neni 189, paragrafi 13.2 dhe 13.3, ku tregohen gjodat për shkelje të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, respektivisht.	Ligji Slloven shumë mirë parasheh dispozitat ndëshkuese për edhe për personat juridik, mirëpo edhe për personat fizik (bizneset individuale), sipas shkeljes dhe shumës së shkeljes: “Një gjobë prej XX do t'i ngarkohet personit juridik apo ndërmarrjes individuale	Për dallim nga vendet tjera, ligji danez nuk parasheh limite të caktuara për gjoba për shkelje, por thekson se “kushdoqoftë” që qoftë me neglizhencë apo me dashje bën një shkelje, do të kompenzojë një shumë të arsyeshme për përdorimin e së drejtës autoriale, dhe do të paguajë për çfarëdo dëmi shtesë të shkaktuar ndaj pales së dëmtuar (përfshirë fitimin e humbur).

Shqipëri	Kroaci	Slloveni	Tjetër
<p>e Autorit..”</p> <p>Krahas kësaj, parashihen dënime bazuar në llojin e kundërvajtjes pavarësisht statusit ligjor.</p>		<p>për shkeljet si në vijim..”</p> <p>Krahas kësaj, ligji parasheh edhe dënime (më të ulëta) për individë privat.</p>	<p>Ky model do të ishte më i përshtatshëm në shtete me gjyqësor shumë të zhvilluar</p>

VI. REFERENCAT

- “Arben Zharku”. Intervistë. 17 Nëntor. 2015
- “Ardita Zejnullahu”. Intervistë. 18 Nëntor. 2015
- “Eljesi Surdulli. Intervistë. 16 Nëntor. 2015.
- "Kujtesa Nezaj." Intervistë. 13 Nëntor. 2015.
- Ligj Nr. 9380 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të. (2005, Gusht). *Shqipëri*.
- Ligji Federal për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. (2011, Janar). *Konfederata Zvicerane*.
- Ligji i Konsoliduar i Republikës së Kroacisë mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. (2015, Janar). Zagreb.
- Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. (2011, Nëntor).
- Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. (a.d.). *Serbi*.
- Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. (2007, Janar). *Slloveni*.
- “Lulzim Syla”. Intervistë. 16 Nëntor. 2015.
- Revista Autori.Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sportit. *Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta*. (2015, Shtator). Prishtinë.
- Rregullore Nr. 01/2012 për procedurat e dhënies, përkatësisht marrjes së lejes, shoqatave për administrim kolektiv të të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të përafërta . (2012).
- Rregullore Nr. 05/2013 për Ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. (2013).
- United States Copyright Office. (2015). *Orphan Works and Mass Digitization*.
- “Valon Kashtanjeva”. Intervistë. 16 Nëntor. 2015.

VII. SHTOJCA I

Direktivat Evropiane

- Projektligji mbi të drejtat e Autorit ka synim transpozimin e direktivave të mëposhtme të Bashkimit Evropian:
- Direktiva 93/83/EEC e datës 27 Shtator 1993 e cila ka synuar lehtësimin e transmetimit ndërkufitar të programeve audio-vizuale, përkatësisht transmetimit me satelit dhe ritransmetimit kabllorë (OJ L 248, 06/10/1993),
- Direktiva 2001/29/EC të datës 22 Maj 2001 mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në shoqërinë e informacionit (OJ L 167, 22/06/2001),
- Direktiva 2001/84/CE e datës 27 Shtator 2001, mbi të drejtën e rishitjes, respektivisht përfitimin e autorit të një vepre origjinale të artit (OJ L 272, 13/10/2001),
- Direktiva 96/9EC e datës 22 Maj 2001, mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave, (OJ L 077, 27/03/1996),
- Direktiva 2006/115/EC e datës 12 Dhjetor 2006, për drejtat mbi qiradhënien dhe huazimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave e përafërta në fushën e të drejtave pronësore intelektuale (OJ L 376, 27/12/2006),
- Direktiva 2004/48/EC e datës 29 Prill 2004, mbi zbatimin e të drejtave pronësore intelektuale, (OJ L 195, 02/06/2004),
- Direktiva 2009/24/EC versioni i kodifikuar e datës 23 Prill 2009 e cila ka harmonizuar legjislacionin Evropian në lidhje me mbrojtjen e programeve Kompjuterike (OJ L 111, 05/05/2009),
- Direktiva 2011/77/EU të datës 27 Shtator 2011 mbi kohëzgjatjen e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, (OJ L 265, 11/10/2011, p. 1 – 5), e cila direktivë ka ndryshuar Direktivën 2006/116/EC e datës 12 Dhjetor 2006 (OJ L 372, 27/12/2006, p. 12-18),
- Direktiva 2012/28/EU e datës 25 Tetor 2012 mbi përdorimin e lejueshëm të veprave jetime, (OJ L 299, 27/10/2012).

Implementuar nga:

Realizuje:



Përkrahur nga:

Omogučio:

